



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 12-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më
15. 12. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Albulena Gashi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic, anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor DBF
3. Remzi Mehmeti, DMSH
4. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
5. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
7. Feti Krasniqi, Drejtor i BPZHR
8. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
9. Ahmet Maksuti, zyra ligjore
10. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
11. Bekim Krasniqi, "YAHR"
12. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
13. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
14. Përfaqësuesit e mediave
15. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
16. Rifat Hoxha- përkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Blerim Gashi, në mbledhjen e KPF-së e kam ngritë çështjen e migrimit të popullatës e cila ka marrë hov të madh dhe mendoj se ne si delegat duhet të informohemi për këtë çështje nga organet kompetente edhe pse na nuk mund të ndikojmë shumë por sëpaku të dalim me një thirrje për qytetarë që të ndalojmë këtë migrim.

Vlora Limani-Hajnuni, na kemi sot në rend dite informatën për gjendjen e sigurisë dhe sigurisht do të informohemi edhe për këtë çështje.

Ramiz Qeriqi, unë e përkrahu parafolësin dhe e di se na nuk mund ta ndalojmë këtë çështje me që shkojnë për kafshatë të gojës.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, 1 kundër për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e KK-së
2. Informatë lidhur me planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve vjeshtore 2014-2015 të DBPZHR.
3. Informatë për punën e deritanishme të KKS-së të Lipjanit.
4. Plotësimi i Komiteteve me anëtar nga radhët e PDK-së

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës Kryesuesja pyeti anëtarët se a don dikush fjalën.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së ngritim çështjen e mospagesës së meditive për mbledhjen e kaluar ku dihen mirë arsyet pse ne e kemi lëshuar mbledhjen e gjithashtu e njëjta mbledhje më vonë për shkak të mungesës së kuorumit është ndërprerë dhe vazhdimi i saj është bërë në fillimin e muajit tjetër dhe ne nuk e kemi pa të arsyeshme që të marrim pjesë në vazhdimin e mbledhjes.

Çështje tjetër është që Mërgim Oruqi është caktuar në panelin përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve në Komitetin Konsultativ për Kultur, Rini dhe Sport e që është thënë se vjen nga shoqëria civile dhe kjo nuk qëndron me që Mërgim Oruqi ka kaluar në LDK dhe nuk mund të jetë anëtarë i këtij paneli.

Linda Shahini, unë ngrit shqetësimin lidhur me krijimin e deponive të egëra në disa vende në Magur siqë janë te varrezat dhe te shkolla dhe kërkoj që të mirren masa ndaj qytetarëve të cilët hudhin mbeturinat në këto vende e gjithashtu kërkoj që të ndëshkohen në mënyrë që të eliminohen këto deponi. Gjithashtu paraqesë shqetësimin e qytetarëve të fshatit Kraishtë të cilët kërkojnë vendosjen e shenjave në rrugë me që është rrezik të kalojnë rrugës sidomos në ditët me mjegull.

Ramiz Qeriqi, në emërtimin e rrugëve ka mjaft ankesa të qytetarëve, andaj është mirë që këto ankesa të shqyrtohen me që ka rrugë që janë emërtu me emra që nuk kanë kurrfarë historie por i kanë bërë për shkak të njerzëve që janë në pushtet. Sa i përket Mërgim Oruqit që e përmendi z. Hoxha është e vërtetë se është anëtarë i LDK-së.

Edita Gashi, paraqiti shqetësimin e mbylljen së kanalizimit në Babush të Muhaxherëve dhe kërkoj që Komuna të intervenoj sa më parë në rregullimin e këtij kanalizimi.

Vlora Buja, në emër të grupit parlamentar të PDK-së kërkoj që kërkesa e shërbyesve civil për ndarje të ndihmës për festat e fund vitit të aprovet.

Burbuqe Ilazi, unë paraqes shqetësimin tim e që është edhe shqetësim familjar ku Kryetari i Komunës e ka hjek nga prioriteti asfaltimin e rrugës të lagjës Ilazi e cila rrugë edhe lidhë fshatin Torinë me Ribarë të Vogël.

Enver Kozhani, si anëtarë i Kuvendit po e ngriti një shqetësim për shëndetësi ku qytetarët e Lipjanit me rastin e vizitave në QKMF në Lipjan aty nuk ju ofrohet asgjë nga barnat esenciale e gjithashtu mungojnë edhe barnat për trajtimin e gjendjeve emergjente të hyper tensive. Në javën e fundit qytetarët ankohen edhe për mungesë të shiringave dhe gjylypërave. Momentalisht në QKMF mund të merren vetëm shërbimet nga mjeku dhe motrat medicinale dhe të gjitha tjerat, medikamentet, inxeksionet duhet të blehen nga vet qytetarët këtë po e flas me që personalisht e kam pasur nënën time në vizitë mjekësore për tri ditë rresht dhe se përveq shërbimit që ishte në nivel të tjerat mu desht me i ble vet. Kërkoj që nga Drejtoria Komunale e shëndetësisë të merren masa në mënyrë që të ketë furnizim të duhur për qytetarët e Lipjanit me që shumica e pacientëve janë në kushte të rënda sociale.

Merita Zeqiri, dashta ta shtroj një pyetje se a ka pasur ndonjë kërkesë nga shoqata e familjeve të Dëshmorëve për ndonjë pagesë meqë me sa jam e njoftuar unë ata kanë parashtruar një kërkesë por ajo kërkesë nuk ka ardhur këtu në Kuvend.

Ramiz Qeriqi, dashta mu lidhur me diskutimin e Meritës dhe ju njoftoj se shoqata e familjeve të Dëshmorëve nuk ka kryesi por janë vetëm dy anëtarë dhe më heret unë kam qenë Kryetar i kësaj shoqate dhe pas mbajtjes së Kuvendit jam tërheqë dhe kjo shoqatë ka mbetur pa kryesi vetëm me dy persona ndoshta edhe kjo është arsyeja që nuk dinë se kujtë me i qitë mjete.

Merita Zeqiri, pavarësisht sa anëtarë janë në atë kryesi unë e di se ata kanë kryer punë çdo herë e posaqërisht për festën e 28 Nëntorit ajo shoqatë i ka shpërndarë thirrjet për mbledhjen solemne për familjet e Dëshmorëve, kurse kësaj radhe për festën e 28 Nëntorit Drejotrati për Rini, Kulturë dhe Sport nuk ka dërguar thirrje familjeve të Dëshmorëve.

Hajrije Salihu, e përkrahu parafolësen dhe konsideroj se shoqatat e dalura nga lufta duhet të ndihmohen e sidomos duhet të ftohen për çdo festë.

Nazmi Krasniqi, gjatë këtij viti ka pasur lëshime të mëdha dhe nuk ka pasur transparencë sa duhet, ka pasur shkelje të ligjëshmerisë dhe unë nuk jam i knaqur me punën e gjerëtanishme. Pastaj tha se na është ndalë medijtja anëtarëve të Kuvendit dhe konsideroj se kjo është bërë në mënyrë të paligjeshme.

Vlora Limani – Hajnuni, ne të gjithë jemi këtu anëtarë të Kuvendit me votë dhe neve na obligon Ligji me dhënë kontributin tonë si anëtarë të Kuvendit.

Me që diskutime tjera nuk patu u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 11-të të Kuvendit?

Me që askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, as plotësime Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 11-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informatë lidhur me planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve vjeshtore 2014-2015 të DBPZHR.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Feti Krasniqi Drejtor i DBPZHR i cili në vazhdim përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Hajrije Salihu, kjo informatë është shumë e rëndësishme por dashta të pyes pse në këtë informatë nuk është përfshi ekonomia e shkollës profesionale “Adem Gllavica” në Lipjan dhe konsideroj se është dashtë të përfshihet në këtë informatë.

Nazmi Krasniqi, kjo informatë nuk ka përfshi ato që duhen të përfshihen siqë e tha edhe profesoresa që nuk është përfshi ekonomia e shkollës profesionale “Adem Gllavica” ku posedon një sipërfaqe të tokës prej 30 hektarë a në anën tjetër flasim për mbjelljet e grurit si në Smallushë e në disa fshatra.

Agron Hajdini, kjo informatë na jep mjaft detaje dhe sipas sajë shihet se mbjelljet vjeshtore krahasuar me vitin e kaluar në këtë vit mbi 14% e sipërfaqeve është më shumë e mbjellur. Në vazhdim është shqetësues çmimi i ulët i grurit me 0.18 €. Pastaj tha se në këtë informatë është përfshi variateti i farërave si dhe u është preferu bujqëve që mos të mbillen rretsht e njejtat kulturë në të njejtin vend por të bëhet ndërrimi i kulturave për shkak se me ndërrimin e kulturave rendimentet janë më të larta. Në fund këkoj nga DBPZHR që të kontaktoj më shumë me donatorë dhe të kërkohet nga ta subvencionimin e bujqësisë.

Blerim Gashi, falenderoj Drejtorin për informatën e paraqitur e cila informatë tejkaloi suazat e informatës dhe kaloi në raport. Pastaj tha se Drejtori përmendi disa komuna siqë është Komuna e Podujevës, Fushë Kosovës dhe Therandës që në planifikim të buxhetit janë largë nga Komuna e Lipjanit. Në vazhdim tha unë edhe më herët kam kërkuar që planifikimi i buxhetit për bujqësi të jetë më i madh me që mjetet që planifikohen për këtë Drejtorat janë shumë pak, andaj edhe tani po kërkohet që me buxhet për sektorin e bujqësisë qasja të jetë më ndryshe se gjerë më tani.

Pastaj tha se me këtë informatë nuk janë përfshi pronat e kooperativës se kush i shfrytëzon a flitet se janë dhënë 180 hektarë në shfrytëzim. Në fund tha se kam dësgjuar se në nivel komunal është formuar një komision apo komitet për hartimin e strategjisë së zhvillimit e dashta të pyes se në qfarë baze është formuar ky Komitet kush e ka formuar dhe qka është duke punuar.

Valbona Shillova, unë po e ngris shqetësimin e bujqëve të fshatit Topliqan dhe fshatrave për rreth për shkak të dëmeve nga vërshimet që bënë lumi Sitnica shumë vite me radhë andaj pyes se a ka ndonjë projekt për rregullimin e shtratit të lumit Sitnica në mënyrë që të evitohen dëmet nga vërshimet.

Florent Hoxha, falenderoj Drejtorin për paraqitjen e kësaj informate ku në mënytë statistikore është paraqitur planifikimi i të mbjellave vjeshtore dhe unë nuk e di se sa kanë mund bujqit me e realizuar këtë planifikim për mbjelljet vjeshtore e gjithashtu pyes se Drejtoria a ka subvencionu fermerët për këto kultura që i ka planifikuar për mbjellje.

Si qështje tjetër që është me rëndësi për të përmendur është qështja e furnizimit me produkte të farërave dhe plehrave dhe pyes se sa inspekcioni ka bërë kontrollimin e këtyre produkteve se qfarë cilësie kanë se nga bujqit ka pasur shumë ankesa se cilësia e plehut ka qenë e dobët. Në vazhdim foli lidhur me kuotën për realizimin e subvencionimit e cila konsideroj se është e lartë kuota prej 2 hektarëve dhe kërkoj që kjo kuota në kuadër të mundësive të zvogëlohet.

Ramiz Qeriqi, tokat bujqësore që janë shitur, pronarët e tyre a kanë ndonjë kusht që t'i punojnë ato apo bëjnë qka të dojnë.

Zoran Çirkoviq, falenderoj Drejtorin për bashkëpunim me konunitetin tonë ku edhe bujqit nga komuniteti serb janë të kyqur për realizimin e subvencioneve në lëminë e bujqësisë. Në vazhdim tha se te kooperimi në Grackë është duke u bërë diqka dhe unë e di se këtë objekt e ka marrë një kompani e quajtur "Egëzoni" dhe diqka është duke u punuar në këtë objekt e gjithashtu flitet se kjo kompani i ka dhënë dikujt objektin dhe në këtë objekt do të hapet një fermë për majmërin e vjetave dhe këtë po e kundërshtojnë qytetarët e fshatit Grackë edhe serbët edhe shqipëtarët dhe kërkoj që Drejtori të merr masa për këtë.

Arben Bahtiri, shumë qështje u ngritën nga parafolësit dhe unë do të flas për subvencionet. U tha nga Drejtori se janë dhënë 78 sera apo mini sera e gjithashtu ndoshta do të ipen edhe 78 sera për vitin e ardhshëm dhe pyes se a do të funksionojnë këto sera. Në KPF është përmend qështja se për 150 hektarë u është dhënë fara e Lulediellit dhe plehut dhe pyes se a është mbjellë ajo farë apo jo dhe nëse jo atëherë duhet me pasur mekanizma për sanksionim.

Nga Drejtori u tha se në të kaluarën nga Ministria e bujqësisë janë subvencionu 876 fermer për mbjellje të grurit dhe se këtë subvencion e kanë realizu edhe disa që nuk kanë pasur fare të mbjellur grur, andaj duhet të kemi kujdes që të subvencionohen vetëm ata fermer që me të vërtetë e meritojnë. Komuna tjera siqë është Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Gjilanit etj kanë dhënë më shumë subvencione se sa Komuna e jonë, andaj ne si Komunë agrare që jemi duhet të subvencionojmë më shumë fermerët. Në fund tha se është folë shumë për qenët endacak dhe u tha se për tri vitet e ardhshme janë planifiku nga 10 mijë euro në vit për eliminimin apo trajtimin e qenëve endacak dhe është mirë që kjo qështje të realizohet meqë më së shumti po pësojnë fëmijët e sidomos tani kur jemi hyrë në kohën e ngricave.

Feti Krasniqi, do të mundohemi të përgjigjemi në pyetjet që parashtruat e një ndër to ishte edhe qështja e ekonomisë bujqësore të shkollës e cila është pjesë e planifikimeve dhe realizimeve këtu. Ky Kuvend në përbërje tjetër i ka dhënë ekonomisë së shkollës 100 hektarë tokë në shfrytëzim dhe kjo ekonomi e shkollës ka potenciale me e mbajtë vetëveten dhe ne me Kryetarin e kemi bërë planin për rikonstruimin e kësaj ekonomie.

Sa i përket planit të mbjellave që tha Nazi se janë bërë prej zyrës unë ju them se këto që i kemi paraqitë në informatë janë të marrura nga tereni. Sa i përket planifikimit në buxhet për bujqësi ky buxhet duhet të jetë më i madh se në të kaluarën. Sa u përket vërshimeve dhe dëmeve nga vërshimet për fshatin Topliqan ju njoftoj se kemi dalë në teren dhe kemi bërë fotografimet e pronave që janë nën ujë dhe kemi kërkuar nga Ministria kompetente që në kuadër të mundësive të

planifikon mjete për rregullimin e shtratit të lumit Sitnica me që na si komunë nuk kemi mundësi. Sa i përket subvencionimeve nga Ministria për vitin e ardhshëm janë planifiku 50 milion euro për subvencionime në zhvillim të bujqësisë. Në vazhdim foli lidhur me cilësinë e farërave, plehrave si dhe kopetencave të komunës për kontrollin e tyre duke shtuar se këto kontrolle duhet të bëhen në kufi që nuk është kopetencë e jona si Komunë e jo në pikat e shitjes. Sa i përket çështjes së Grackës që e përmendi Çirkoviqi konsideroj se aty është duke u bërë diçka që është në interes të Komunës.

Vlora Limani-Hajnuni, kjo është informatë dhe nuk votojmë për aprovim andaj kalojmë në shqyrtimin e pikës së tretë.

Shtesë: Informata.

III

Informatë për punën e deritanishme të KKSBB-së të Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Haqif Rustemit përfaqësues i DMSH-së dhe anëtarë i KKSBB-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata, duke shtuar se në KPF është kërkuar që në Kuvend të diskutohet edhe çështja e shpërnguljes së komuniteteve dhe mendoj se askush nuk mund të jetë ekzaktë shifren se sa janë shpërngulur.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, e përkrahu informatën mbi punën e KKSBB-së dhe për mua është shqetësuese çështja e migrimit dhe kjo nuk është vetëm në Komunën tonë por është në tërë Kosovën dhe është mirë që KKSBB-ja të merr informata se sa është numri i atyre që janë shpërngulur.

Xhevat Olluri, e përkrahu informatën mbi punën e KKSBB-së.

Sa i përket shqetësimeve që i përmendi Haqifi për qenët endacak ku përmendi që për një qenë kanë kërkuar 60 euro për trajtim për një muaj unë dashta të pyes se a është vetëm një kompani që mirret për trajtimin e qenëve apo më shumë.

Shqetësim tjetër është çështja e migrimit të popullatës dhe unë mendoj se ka rregulla për transportin e udhëtarëve si dhe orarë të qarkullimit të tyre dhe pyes se qfarë masa janë ndërmarre ndaj transportuese që po i bartin këta njerëz.

Blerim Gashi, unë e përkrahu këtë informatë dhe kërkoj publikisht që ta senzibilizojnë çështjen e migrimit dhe nëse ka mundësi propozoj që të thirret edhe mbledhje e jashtëzakonshme. U tha se migrimi po bëhet për çështje sociale dhe unë mendoj se përveq kësaj ka ndiku edhe mos formimi i institucioneve. Në fund kërkoj që edhe për qenët endacak të mirren masa sa më shpejt.

Ramiz Qeriqi, na shqetëson çështja e migrimit por na si Kuvend nuk mund të ndikojmë në këtë por këtë duhet ta bëjë Qeveria e Kosovës.

Florent Hoxha, ne e kemi shqyrtu këtë informatë si PDK dhe sipas saj shifet puna që ka bërë KKSBB-ja.

U përmend se KKSBB-ja ka pasur planin e veprimit dhe ky plan nuk është realizu në përgjithësi e që konsideroj që kjo ka ndodhë për shkak të implikimeve buxhetore. Në vazhdim tha se më herët kemi informu disa ekipe të veprimit dhe pyes se sa kanë qenë funksionale ato ekipe.

U fol mjaft për qentë endacak si dhe rritjen e numrit të tyre dhe e di se është e ndaluar vrasja e tyre por kërkoj nga Qeveria të merr masa në kuadër të mundësive për zvogëlimin e numrit të tyre.

Sa i përket migrimit të popullsisë kjo është shqetësuese dhe mendoj se kjo po ndodh për shkaqe sociale ku një pjesë e tyre kanë shitur pronat për të shkuar jasht. Unë kam dëgjuar se Suedia do t'i kthej të gjithë dhe nëse kjo ndodh atëherë do të jetë një barrë për institucionet që mirren me këtë çështje.

Nehat Tërpeza, unë kam një pyetje për përfaqësuesin e KKSB-se e që kam pritur në këtë mbledhje që të jetë edhe përfaqësuesi i policisë dhe pyetja është: a duhet të jetë policia vetëm në vendet urbane apo edhe në vendet rurale me që në vendet rurale siguria është e mangët e sidomos në afërsi të shkollave ku frekuencat e nxënësve janë të mëdhaja.

Shqetësim tjetër kam lidhur me transportin e udhëtarëve ku kemi transportues të cilët transportojnë udhëtarët pa leje e që konkretisht kemi pasur një rast në Shalë ku një vozitës i autobusit ka lajmëruar policien për një transportues ilegal i cili më vonë ju ka kërcnuar vozitësit të autobusit dhe për këtë janë të njoftuar policia, andaj mendoj se ka vend për shqyrtimin e këtyre qështjeve në KKSB.

Feti Krasniqi, lidhur me qështjen e migrimit të popullatës po them se edhe si popull jemi të prirur me rreziku por ne si Kuvend nuk mund ta ndalim këtë. Sa u përket qenve endacak me Kryetarin e kemi bërë një plan dhe mbrenda 2-3 dite 100 qenë do t'i merr qendra strahimore në Halilaq dhe planin tjetër më afatëgjatë e kemi që të ndërtojmë qendrën strehimore në Lipjan për qenët endacak.

Enver Kozhani, kam pritur që në këtë mbledhje të jetë prezent edhe Komandanti i policisë në mënyrë që të na njoftoj me dukurit e vjedhjeve të cilat janë duke ndodhur dhe kërkoj që të shtohen patrullat e policisë në vendet rurale.

Pasi diskutime tjera nuk pati lidhur me këtë pike u kalua në shqyrtimin e pikës së katërt.

IV

Plotësimi i Komiteteve me anëtar nga radhët e PDK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni tha se e kam përmendur edhe në KPF dhe po e përsërisë tani që PDK-ja për KPF është dashtë ta respektoj barazinë gjinore.

Pastaj i dha fjalën Florent Hoxhës.

Florent Hoxha, ne si PDK e kemi njoftuar Kryesuesen me shkrim me emërat e anëtarëve që do të jetë në Komitete nga PDK-ja. Në vazhdim tha se siqë e dini edhe ju u bë një vit që na nuk i kemi pasur përfaqësuesit nga PDK-ja në Komitetet e Kuvendit me që kemi bërë ankesë që përfshirja në Komitete të bëhet më me shumë anëtarë nga PDK-ja me që kemi numrin më të madh të anëtarëve në Kuvend por kërkesa e jonë nuk është marrë parasysh. Pastaj njoftoj me propozimin e anëtarëve për Komitete nga PDK-ja duke shtuar se nga lista të cilën e kemi dërguar kemi një ndryshim që në vendë të Burbuqe Ilazit që është propozuar Kryesuese për Planifikim dhe Urbanizëm të caktohet Feriz Hasani.

Feriz Hasani, është mirë që të respektohet barazia gjinore por edhe subjektet tjera nuk e kanë respektu.

Vlora Limani-Hajnuni, ky Vendim për formimin e Komiteteve është aprovuar më heret dhe nuk kemi nevoj që të votojmë se sikur mos të ishte aprovuar nuk do të kishte kaluar sot me që nuk kisha pranuar që mos të respektohet barazia gjinore.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,³⁰

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni***